

RIFINITURA



PINTOFINISH

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
E bardhë	Thes, 15 Kg	1.2-1.5 (kg/m ²)/mm trashësi

PËRSHKRIM

Stuko patinimi me bazë çimento të bardhë, e përbërë nga gëlqere e hidratuar, rërë të cilësisë së lartë, rezina sintetike speciale dhe aditivë specifike. Karakterizohet nga një punueshmëri e shkëlqyer, hapje shumë e mirë si në sipërfaqe horizontale ashtu dhe vertikale. Lejohet aplikimi deri në 3 mm trashësi. Pas fërkimit me letër smerile jep një rifiniture të lëmuar.

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret për stukimin e mureve, tavaneve në sipërfaqet karton gips, fino dhe në suva, për ambiente të brëndshme të cilat do të mbulohen me vone me bojë, letër muri apo veshje dekorative. Stukoja e patinimit duhet të aplikohet në temperaturë nga +5°C deri në +35°C.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Bazamenti duhet të jetë i pastër pa pluhura, vajra, bojra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Pastrimi i bazamentit bëhet në mënyrë mekanike ose manuale. Nëse suporti ka disnivele të mëdha atëherë duhet të bëhet nivelimi i tij.





APLIKIMI

Përzjeni 5-5.5 litra ujë me një thes 15 kg produkt me përzierës elektrik më numër të vogël rrotullimesh, derisa të arrihet një masë homogjene dhe pa kokrriza. Lëreni produktin në qetësi për 5 min dhe përzjejeni përsëri përpara përdorimit. Aplikoni produktin me një mallë inoksi dhe bëni nivelimin e saj, në një trashësi prej 3 mm. Kushtet atmosferike ndikojnë në kohën e tharjes së produktit.



TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Koha e magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit
Paketimi: Thes letre 15 kg në paleta 1080 kg	Masa vëllimore (i thatë): 1.5 gr/m ³
Ngjyra: E bardhë	Ujë për përzierjen: 5.5-6 litra ujë për thes
Kokrrizimi: < 0.1 mm	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Konsumi: 1.2-1.5 kg/m ²	Rezistenca në shtypje: ≥ 1.6 N/mm ²
Trashësia e aplikimit: 3mm	pH: 13
Mënyra e aplikimit: 2 duar	Thithja e ujit: WO
Koha e pritjes për dorën e dytë: 1 orë	Reaksioni ndaj zjarrit: A1 Class
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri	



Kujdes! Nuk rekomandohet aplikimi i finos ne suporte me fleksibilitet te larte si sistemi kapot apo produkte te tjera fleksibel , ne sipërfaqe te paqëndrueshme ose ne disnivele te medha . ! Si temperaturat e ulta dhe temperaturat e larta mund te ndryshojne karakteristikat e punimit te produktit (ngadalsim ose pershpejtim ne tharje te produktit). Mos e përdorni në:

- Suporte druri,metali, PVC apo sipërfaqe të tjera jo me bazë çimento.
- Në ambiente ku ka lagështirë të vazhdueshme,
- Suporte që karakterizohen nga vibrime të paqëndrueshme.
- Në temperatura të larta, të ulëta, me erë të fortë.